

Komuna e Mamushes

Data: 29.07.2020

Mledhja e 06 e Rregullt e Asamblese Komunale

Vendi: Mamushë

PROCESVERBAL

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Beledijesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
01	No.Nr. 08/A-20
Tarih/Dt. 29.07.2020	

Mledhja e 06 e Rregullt e Asamblese Komunale është mbajtur me datë 29.07.2020 në ora 10:00 në sallën e Asamblesë Komunale.

Mbledhja është udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit Z.Buyar Mazrek.

Në mledhje kanë marrë pjesë 14 anëtarë

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtar të Asamblesë, të nderuar misafirë mirë se erdhët në mbledhjen e 06 të rregullt të Asamblese Komunale për vitin 2020. Mledhja është mbajtur në ora 10:00.

Rendi i dites:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores se tatimit ne prone per vitin 2021
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit komunal per menaxhimin e mbeturinave
5. Të ndryshme

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtarë , a ka dikush diçka me shtu në lidhje me procesverbal, nëse jo atëherë votojmë.

-Po 14

-Jo 0

-abstenim 0

Me vota unanime prosesverbali u pranua.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diçka me shtu në rend te ditës, urdhëro Z. Kryetar.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Ju përshëndes të gjithëve, në fakt këtë pikë nuk kemi menduar që ta vëmë në rend dite por në fund ka ndodhur një ndryshim. E dini që më herët e kemi ndarë një buxhet për festivalin e domates dhe pasi kemi dal me tender kanë mbetur 11.300.00€. Pra i kemi planifiku 76.000.00€ për mjetet bujqësore kurse ne kemi nënshkruar marrëveshjen në vlerë prej 65.500.00€. Nëse ju kujtohet më herët ka qenë një trafo e prishur tek varrezat e vjetra dhe për me funksionu pompa e kemi hek një trafë prej një pjese tjetër dhe e kemi dërgu aty. Në takimet që i kemi zhvilluar me Keds-in kemi marrë përgjigje negative dhe kisha kërkuar prej juve që nga këto 11.000.00€ ti ndajmë 10.000.00€ për blerjen e trafos së re dhe për renovimin e disa shtyllave elektrike. Faleminderit.

Fuat Taç:

Ju përshëndes të gjithëve, në qendër ka qenë trafoka përse nuk është vënë përsëri, ku është ajo trafik Z. Kryetar?

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Ajo trafik është hequr para se me u thy. Në takimet e zhvilluara me Keds-in po thojnë që ajo trafik më nuk mund të përdoret.

Fuat Taç:

Spas mendimit tim ajo trafik është vjedhur, unë i di pak a shumë punët më rrymë dhe e di që ajo trafik nuk mund të prishet.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Jo nuk është e prishur por nuk mund të përdoret.

Fuat Taç:

Nuk ka gjasa mos me u përdor, në atë pjesë është e përdorueshme, sipas mendimit tim ju së bashku me ekipin e jau duhet të takoheni me Kedsin dhe ti thoni që ajo trafik është e komunës, pse me nda buxhet për trafik kur trafon e kemi. Nuk po mundemi me vlerësu trafon që e kemi dhe po dojmë me shpenzu pare pa nevojë. Ju prap vendosni por sipas mendimit tim ky është gabim. Ky është keqmenaxhim.

Halim Sadiku:

A ban me ma spjegu shqip Z. Kryetar?

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Halim, për shkak që një trafik është mangi, disa herë kemi bo kërkesë zyrtare edhe kemi kërku trafik të re edhe trafën e përdorne edhe kedsi përgjigjen zyrtare për trafon e vjetër që e kanë hek po thojnë që na si keds nuk e shfrytëzojmë atë trafik. E tjetra, na planifikum sepse ajo lagja nalt veq u ndërtu bajagi dhe trafoka që është aty është shumë e vogël dhe na po mendojm që atë trafën prej aty që asht 120 me hek edhe me qu poshtë për fushën që është mangi edhe aty me pru një trafik mat madhe për nevojat e kopmplet lagjes. Qekjo është ajo kërkesa edhe disa shtylla që janë të thyme edhe disa shtylla me i shtu për me i aktivizu do vende, qekjo është kërkesa, atë trafon prej atyhit me hek me qu ku asht mangi edhe aty me pru një trafik ma të madhe.

Halim Sadiku:

Kuptova plotësisht. Unë e përkrahi propozimin e kryetarit, për shkak se trafa e vogël atje, me hek atë edhe me zavendësu nja të madhe aty ku është kërkesa edhe zhvillimi më i madhë për shkak se janë edhe ni fabrikë apo dy. Po nuk e përkrahi ndryshimin e projektit që është bo për ujitjen e fushave domethënë janë vendos komplet kontra, trafa aty ku duhet m zhvillimin e mamushës po trafa është vendos ku mamusha nuk ka mu zhvillu edhe 15 vjet domethënë ka shku kontra. Tash na si qytetar po duhet me marrë iniciativat tona edhe me marrë prej asaj trafës rrymën edhe me pru kontra knena. Ky është një gabim shumë i madhë, përndryshe propozimi i kryetarit nuk po më duket i pa arsyeshëm për shkak se është e nevojshme mu ndryshu ni trafik. Trafa ma e vogël vendoset në vendin ku ka nevojë kurse më e madhja le të vendoset në lagjen lartë. Faleminderit.

Fuat Taç:

Kur foli kryetari për të parën herë nuk tha për ndryshim, tha duhet me ble, me hargju pare. Shumë lehtë është me shpenzu pare, ne ose jemi të qmendur ose dikush po na shfrytëzon neve, për këtë arsye thash që un jam kundër këtij propozimi. Pasi që po doni me shtu si pikë të rendit të ditës unë po pyes përse trafoka që ka qenë në qendër nuk po vendoset diku, ajo trafik nuk është e prishur, nëse ju nuk mundeni me e sjellë

atë shumë haptas po ju them që me 7,500,00€ që tha anëtarë që duhet me i mledhë, le të mi jep mua ato pare unë e vendosi trafon ku duhet mu vendos. Unë nuk po mundem me kuptu këtë punë, athu stafi është i qmendur ose ne po ndajmë mjete pa nevojë për atë trafë.

Nehat TAÇ:

Përse po kërkon pare pasi që paske ti fuqi edhe mundësi për me vënë trafon?

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diqka me shtu rreth kësaj pike, urdhëro Z. **İlyas Bayraktar**?

İlyas Bayraktar:

Ju përshëndes të gjithëve, së pari ngushllime kryetarit për vdekjen e nënës, sa i përket trafos ne këto 11,000,00€ mundemi me i bartë, ama siq tha anëtarë ne mundemi me e marrë atë trafë mrapa, në rregulll është, ne ashtu ashtu kemi nevojë për trafo të reja sepse kemi fusha të hapura mjaft, nëse ti ke dikë të njofshëm shumë mirë është, e montojmë diku tjetër sepse Mamusha po zhvillohet por nëse tani këto mjete po teprojnë dhe është nevoja për atë trafë atëherë ne jemi pro kësaj. Përse me shku mjetet mrapa kur kemi nevojë. Kryetari tha që kemi nevojë për trafë, shtylla elektrike. Ne do ta monitorojmë këtë, normalisht nëse dojmë. Faleminderit.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit

Faleminderit Kryetar, urdhëro FUAT .

Fuat TAÇ

Këto mjete nuk shkojnë suficid.

Necmeddin Morina:

Së pari ju përshëndes të gjithëve, më tregoni dikush prej juve deri më sot a kemi mundur me marrë mrapa diqka nga KEK-u. Dajtë e mi privat i kanë vendos shtyllat elektrike edhe ja kanë dhënë Kekut trafon me qëllim që ta marrin prap por nuk po ia kthejnë, nëse e merr KEK- pas 6 muajve kalon në pronësi të tij, nuk ka gjasa me e rikthy.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit

Këtë qështje e diskutojmë prap, tani votojmë për propozimin e kryetarit për ndarjen e mjeteve për trafo.

Të nderuar anëtarë nëse nuk keni diqka me shtu atëherë votojmë për këtë pikë.

Me vota unanime rendi i ditës u pranua .

3.Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores se tatimit ne prone per vitin 2021

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit

Sa i përket kësaj pike fjalën ia japim Drejtorit për Financa Z. Türker Mazrek.

Türker Mazrek.

Përshëndetje për të gjithë, sot po ua ofrojmë për votim draft rregulloren e tatimit ne prone per vitin 2021, si qdo vit tjetër edhe këtë vit rregullorja duhet njëherë të votohet si draft mandej si rregullore. Në këtë rregullore nuk ka ndryshim të madhë është e njëjta si qdo vit tjetër. Nëse keni diqka me pyet ose me shtu ndonjë propozim urdhëroni. Faleminderit

İlyas Bayraktar:

Shkalla tatimore prej 18% për cilën zonë tatimore është?

Türker Mazrek.

Shkalla tatimore prej 18% është për pronën – komerciale ndërsa 17% është për pronën – industriale.

İlyas Bayraktar:

A jeni bazuar në normat tatimore të komunave tjera shembull me komunën e Prizrenit?

Türker Mazrek.

Po në disa komuna jemi bazuar pra i kemi shfrytëuar normat më të ulëta tatimore, shembull normën tatimore 0,16% nuk po mundemi me e shfrytëzu për të gjithat zonat tatimore, patjetër po duhet me bë ndryshime. Në faqën e parë i keni edhe shumat për zonat tatimore, norma nuk po ndikon shumë por vlerat. Zona e parë e ka shkallën tatimore më të lartë, zona e dytë të mesme ndërsa zona e tretë më të ulët.

İlyas Bayraktar:

Qëllimi është që nëse një fabrikë hapet dhe norma tatimore shfrytëzohet sikur norma në Prizren atëherë kjo është shumë për ne.

Türker Mazrek.

Ne nuk e kemi bërë këtë duke u bazuar në komunat tjera por jemi munduar maximum me pasë norma më të ulëta, nuk i kemi vendosur normat sa i ka vendos komuna e Prizrenit. Faleminderit

Buyar Mazrek

A ka dikush diqka me shtu lidhur me këtë pikë, nëse jo atëherë votojmë.

Me vota unanime kjo pikë u votua.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit komunal per menaxhimin e mbeturinave

Buyar Mazrek:

Lidhur me këtë pikë fjalën ia japim zyrtarit i cili ka qenë anëtar i grupit punues Z. Haşim Morina.

Haşim Morina:

Përshëndetje , do jap disa sqarime lidhur me këtë qështje. Komuna e Mamushës në bashkëpunim me shoqatën Giz dhe me stafin e qendrës për mjedis dhe energji alternative ka hartuar draft planin komunal për menaxhimin e mbeturinave. Për hartimin e këtij plani grupi punues së bashku me stafin i kanë paraparë 6 objektiva më prioritare sa i përket planit, objektivat janë:

- **Hartimi i kuadrit ligjor, rregullator dhe institucional për menaxhimin e mbeturinave – Konsolidimi i strukturës brenda komunës për sistemin e menaxhimit të mbeturinave (2020-2021)**
- **Konsolidimi i shërbimit në zonat ku ofrohet dhe zgjerimi i shërbimit në zonat ku aktualisht nuk ofrohet shërbim (deri në masën 100%) gjatë periudhës 2020-2024**

- Krijimi i një strategjie komunale për nxitjen dhe vetëdijësimin e qytetarëve për minimizimin e mbeturinave. Minimizimi i mbeturinave urbane që shkojnë në deponi me 5% gjatë periudhës 2020-2024
- Sigurimi i qendrueshmërisë financiare, duke optimizuar koston e shërbimit dhe rritjen e nivelit të inkasimeve nga tarifat në zonat ku do të shtrihet shërbimi në masën 100% gjatë periudhës 2021-2024.
- Grumbullimi i ndarë i fraksioneve të ndryshme të mbeturinave, duke evituar hedhjen e tyre në konteinerët e mbeturinave komunale- Shembull të gjitha mbeturinat si plastika, qelqi dhe ushqimore të vendosen në kontënjërë të ndryshëm.
- Eliminimi i 12 deponive të egra të evidentuara në territorin e Komunës së Mamushes gjatë vitit të parë dhe të dytë të zbatimit të planit 2020-2021. Pas ndërtesës së zjarrfikësve është një deponi e egër por ajo është vetëm për mbeturinat e ngurta.

Në bazë të legjislacionit ekzistues, ky plan do të fokusohet në rrymën e mbeturinave komunale për të cilën Komuna e Mamushes është drejtëpërdrejt apo pjesërisht përgjegjëse. Në varësi nga **ekspozimi i rrezikshmërisë** mbeturinat, sipas këtij ligji kategorizohen si: i) mbeturina inerte; ii) mbeturina të parrezikshme; iii) mbeturina të rrezikshme; dhe në varësi të **llojit mbeturinat** klasifikohen në: i) Mbeturina komunale; ii) mbeturina komerciale; iii) mbeturina industriale; iv) mbeturina medicinale. Ky ligj gjithashtu, në *Kreun VI të tij "Përgjegjësitë dhe Detyrimet për Menaxhimin e mbeturinave"* përcakton përgjegjësitë dhe detyrimet për aktorët e mëposhtëm të cilët janë pjesë e ciklit të menaxhimit të mbeturinave:

- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e zotëruesit të mbeturinave** – zotëruesi i mbeturinave është personi i licensuar përgjegjës për mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e prodhuesit dhe importuesit e produkteve** - Prodhuesi i mbeturinave dhe importuesi i mallrave me potencial për krijimin e mbeturinave janë përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave të krijuara nga produktet e tij;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e prodhuesit të mbeturinave** – përgjegjës për menaxhimin e plotë të mbeturinave që prodhon ose dorëzimin e tyre për trajtimin dhe deponim tek personat e licensuar;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e transportuesit të mbeturinave** – ata duhet të jenë të licensuar për transportin e mbeturinave, dhe duhet të kryejnë këtë proces bazuar në kushtet e licensës për transport;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorit për trajtimin dhe përpunimin e mbeturinave** – këta operatorë duhet të jenë të licensuar për trajtimin dhe përpunimin e mbeturinave në impiantin e tyre bazuar në kushtet e licensës;
- **Përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorit në deponi të mbeturinave** - këta operatorë duhet të jenë të licensuar për deponimin e mbeturinave në impiantin e tyre bazuar në kushtet e licensës.

Ky plan të cilin e kemi pregaditur me Gizin është një plan 5 vjeçar i cili përfshin periudhën prej 2020-2024. Përafërsisht 30-35% e amvisërive janë të përfshira në sistemin e shërbimit të deponimit të mbeturinave. Vizioni i këtij plani është:

- “Komuna e Mamushes, një komunë model në ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave dhe në arritjen e standarteve të larta të qëndrueshmërisë të mjedisit, ekonomisë dhe shëndetit të sigurtë publik”.

Në mbledhjen e mbajtur të komitetit për komunitete Halim Sadiku e ka dhënë një propozim që të vihen tabelat ku shkruan ndalohej hudhja e mbeturinave. Ky plan i menaxhimit të mbeturinave perbehet nga 65 faqe por ne u munduam vetëm në pika të shkurtëra të japim disa sqarime , nëse keni diqka me pyet urdhëroni.

İlyas Bayraktar:

Pas klasifikimit të mbeturinave a dihet se ku do të hudhen ato.

Haşim Morina:

Po do të hudhen në disa vende dhe ato vende do të përcaktohen në fazën e fundit të planit.

İlyas Bayraktar:

Ju po thoni që tani në sistem të pagesave janë të kyqur vetëm 30-35% e amvisërive por në bazë të cilit plan po mundoheni që të rritni numrin e amvisërive nga 30 % në 70%?

Haşim Morina:

Fazë fazë do të zbatohet.

İlyas Bayraktar:

Qka keni propozuar si pikë.

Haşim Morina:

Nuk kemi mundur të veprojmë asgjë për shkak të pandemisë. Së pari kemi planifikuar që në shkollë të mbajmë një takim me nxënësit, me familjarë të nxënësve mandej me pregaditë broshura dhe me i vetdijësu qytetarët. Plani është i përbërë prej 65 faqeve dhe aty shkruan detalisht për qdo gjë, ne vetëm objektivat i sqaruam në pika të shkurtra.

İlyas Bayraktar:

Qfarë objektiva keni vënë për ta rritur përqindjen e amvisërive nga 30% në 70%?

Buyar Mazrek

Këtë do ta sqaron Shefkija

Shefkije Morina:

Përshëndetje për të gjithë sipas Ligjit nr.04/l-060 "Për menaxhimin e mbeturinave " qdo komunë obligohet të hartojë dhe zbatoj planin lokal të menaxhimit të mbeturinave si dhe rregulloreve përkatëse për të gjithë komponentët e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave nga Komuna. Ky plan është 5 vjeçar. GIZ-i neve po na ndihmon që ta krijojmë planin, kemi qenë një grup prej 5-6 anëtarëve. Si rezultat i kësaj punëtorie e kemi nxjerrë këtë draft ku së pari i kemi përcaktuar objektivat që i kemi ne si komunë sepse në fakt për ta eliminuar këtë problem kemi shumë objektiva por ne i kemi përcaktuar objektivat që ne mundemi me i arrit edhe me i realizu. Shembull ne nuk mundemi me shku me klasifikim të mbeturinave kurse në anën tjetër qytetarët me vazhdu prap me hudhjen e tyre. Duhet me vazhdu faza faza, kemi një afat prej 5 viteve dhe mbrenda këtyre viteve me shku faza faza. Së pari duhet me fillu me fazën e vetdijësimit të qytetarëve që mbeturinat nuk duhet të hudhen në vende të ndryshme por në kontenjer. Ky plan është një draft, muajin e ardhshëm kalon si plan dhe keni një muaj kohë nëse keni ndonjë propozim ose ide për me shtu ose me hek. Nëse ne e posedojmë një plan të tillë kjo kërkon edhe buxhet shtesë dhe ne e dijmë që buxhetin e kemi të kufizuar por nëse plani realizohet pra nëse e votoni ju atëherë ne kemi të drejtë të kërkojmë edhe grante nga organizata të ndryshme si banka evropiane etj. Ne së pari jemi përqendruar në aspektin ligjor, pra krijimin një rregulloreje të mbrendshme komunale mandej fillimin e mbajtjes së fushatave vetdijësuese, kemi menduar që së bashku me nxënës ta caktojmë një ditë ta pastrimit por për shkak të pandemisë nuk kemi mundur të bëjmë asgjë. I kemi 12 deponi ilegale, një deponi që e ka përcaktuar komuna është vetëm për hudhjen e mbeturinave të ngurta. Këto deponi ne do të mundohemi ti pastrojmë, ti rrethojmë me shirita dhe ti kthejmë në zona të gjelbërta. Qëllimi është që pasi të vetdijësojmë qytetarët ngadal dalë ti fusim në sistem. Për hudhjen e mbeturinave të ngurta është vendi edhe për mbeturinat tjera nëse ngadal dalë futen ne sistem atëherë automatikisht do të elimonohen këto deponitë ilegale, dhe do ti kthejmë në zona të gjelbërta. Mandej do të fillojë ajo faza e klasifikimit, e riciklimit gjë e cila nuk është shumë e rëndësishme për momentin për ne, për ne më e rëndësishme është vetdijësimi i qytetarëve.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Shefkije. Urdhëroni Z. Ilyaz.

Ilyas Bayraktar:

Në bazë të punimeve që i keni zhvilluar me Giz-in qfarë kompetenca po kërkonin prej komunës që të kthehet qdo gjë në legalizim, shembull buxheti.

Shefkije Morina:

Kjo ka me u realizu në bazë të viteve, shembull vitin e parë ka me u përcaktu ligji, mandej duhet të nxirret edhe një rregullore e brendshme komunale, mandej vetdijësimi i qytetarëve, pra për 5 vite arrihet qëllimi.

Ilyas Bayraktar:

Kjo është një gjë shumë e mirë pra të fillohet me vetdijësim por ju si komunë a keni paraparë diqka për familjet që nuk kanë mundësi ti mbulojnë pagesat prej 5 eurove në muaj. Shembull nëse 100 familje nga 4.5 € në muaj, për ni vit po kushtojnë 5.400€, nëse ka nevoja na ndajmë buxhet për ta edhe kjo automatikisht rritet në 50- 70%.

Shefkije Morina:

Në fakt kjo për momentin nuk ka lidhje me buxhet, nëse e votoni këtë plan sot kjo po i hap shumë mundësi, kemi mundësi me apliku në grante në ndryshme. Ne në punëtorinë që kemi marrë pjesë i kemi përcaktuar vetëm objektivat, qdo gjë tjetër e ka pregadit Giz-i. Të gjitha komunat janë të obliguara që ta posedojnë një planë të tillë.

Ilyas Bayraktar:

Inshallah edhe zbatohet pasi që është obligative, nuk mbetet vetëm në letra.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Z. Ilyaz. Urdhëroni Halim.

Halim Sadiku :

Përsëendetje për të gjithë, unë e llogaris këtë projekt dmth mas komunës projekti i dytë më i mirë që është bërë për komunën e Mamushës edhe ky është një prej projekteve më madhore për shkak së këtu asht në pyetje shëndeti. Në qoftëse të gjitha projektet ka qenë desht me i votu me ni dorë unë këtë projekt kam me votu me dy duar, për shkak se të paktën faza e parë le të fillon me vetdijësim. Shembull pse Nexhmedini me gju letrën në rrugë e jio në kontejner, na do ta msojmë atë që le ta merr letrën, mos me gjuajt në rrugë, apo Halimi apo dikush tjetër pa marrë parasysh, domethënë kjo është një prej qështjeve që unë e kam ngrit zonin që na si shoqëri duhet me u vetdijësu. Si shkolla, si xhamia duhet mu vetdijësu mos me hudh mbeturina.

Ilyas Bayraktar:

A është IS Compania tu i mledh?

Halim Sadiku :

Po është tu i mledh ama qytetarët duhet mi vetdijësu, kështu që qeky draft nuk don as diskutim, kjo është një prej hapave më të sigurta për shkak se deri tash nuk është ndërmarrë asnjë gjë, nuk ka asnjë inspektor komunal. Llogaritni që sa vjen Mamusha është komunë ala në asnjë deponi ilegale nuk shkruan ndonjë tabelë që ndalohet hudhja e mbeturinave. Kështu që kjo është një prej projekteve më madhore, ju përgëzoj, urime, veq përpara.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Halim, tani dua ta marrë fjalën unë. Fuati ka qenë kryesues, ju ke qenë kryesues, pra i njëjti problem është që 15 vite edhe prap nuk po i gjindet ndonjë zgjidhje. Sot për sot të gjithë po shetitim, po shkojmë në Mitrovicë, ferizaj, klinë edhe po i shohim lumenjtë në qfarë gjendje janë, njerëzit po shpenzojnë para apo. E si kanë mundur me i parandalu kwtu dukuri sipas juve, me paralajmëruje jo as me ndonjë metodë tjetër por i kanë parandalu vetëm me dënim, me gjoka. Përkundrazi në Mamushë nuk hiqet asnjë mnyrë tjetër, vetëm me parë, po i preke asnjë askush nuk shkon më me hudhë mbeturina. Disa jeni më të vjetër se unë dhe shumë mirë e dini që në të kaluarën mërrnin ujë në lum dhe bënë qaj kurse sot nuk po mund të kalohet në lum nga mbeturinat. Fuat, në kohën e jave e keni pastruar lum nga posht lartë edhe për këtë keni shpenzuar para a po, prap ai lum është i pastër. Propozimi im është për ta mbajtur pastër atë duhet të zbatohen gjokat me parë, asgjë tjetër nuk mundet me e ndalu. Shikojeni pasrkun sa bukur është bënë por a po mundemi me qëndru në kërkim aty, askush. Njerëzit nga Turqia kanë derdhu parë për këtë park. Po marrin 5 kg fara po i hajne edhe plus po fyejnë. E ju nëse që 15 vjet nuk keni mundur me vetdijësu këtë Mamushë kanë me kalu edhe

150 vite tjera edhe ska me u vetdijwsu. Djali im nwse nuk wshtw vetdijwsuar deri nw moshwn 10-15 vjeqare ai mw nuk vetdijwsohet kurrw.

Fuat TAÇ:

Mundesh me na trajtu neve si opozitw por unw po ju pyes se qka kemi bwrw ju mbrenda 3 viteve, ne pwr momentin kemi probleme tw llojllojshme. Nw rregull ke punwsuar staf por a po punojnw. Unw po them qw kemi trafon tonw, perdore, ai mw thot bjermw pare.

Ilyas Bayraktar:

Unw kam respekt pwr fjalwt e anwtarit, mendimi juaj wshtw ndryshe, mendimi jonw wshtw ndryshe. Ju po thuan qe ndalojeni bujqwsinw dhe ta vwnw trafon, kolegw ti vendose trafon, shko merre nga KEDS-i, ne do tw lumturohem i nwse ju mundeni me e realizu kwtw

Fuat TAÇ:

Qe 1 vit askush nuk po e pwrmend qw trafoja wshtw marrw nga qendra e ti po vjen kwtu po thu me nda buxhet. Unw duhet me e lujt rolin e opozitws kwtu e jo ti.

5.Të ndryshme

Aka dikush diqka me shtu në të ndryshmet?

Halim Sadiku

Për qështjen e covidit ma shumë, uroj që të shërohen sa ma shpejtë edhe qeta që janë prek. Po ka ni sen që në Kosovë ka shumë thashethëme, nuk ka nevoj kërkush as mu idhnu as mu krenu, kjo është proces global. Unë i ni zhurmat banvaki ni qytetar e ka naj sebeb edhe nuk guxon me dal në rrugë se meniher thojnë a e paska sebebi juj koronën a? Na mujna me pas krejt banvaki edhe e kemi pas edhe e kemi kalu pa e marrë vesh. Na skemi nevoj me nenqmu atë por kemi nevoj mi dhon moral atij, mi dhon fjalë miradije, pa marrë parasysh, vetëm kru i nin këto sene, tjetër kund jo, kjo është shumë normale, kjo është një grip qëbanvaki krejt njerzimi ka me kalu. Nuk ka nevojë me bo tragjike, unë pe shoh nëpër media, pe shoh shumë të madhe, pe shoh shumë keq, shumë gabim, pse gabim, sepse na jemi prodhues edhe kemi me dal nëpër të gjitha tregjet dhe nëse figuron që Mamusha dominon me covid ka me u ngurtësu ekonomia. Kështu që prej prej të gjithë juve, mos e bani këtë të madhe këtë punë, me qetësi ishalla e kalojmë edhe këtë proces edhe e vazhdojmë jetën normale, rujuni sat muni, mani distancë, mbani higjienë. Faleminderit.

Çamil Mazrek:

Ju përshendes të gjithëve, unë desha me fol pak për QMF-në, kur po shkojnë qytetarët për vizitë mjekët që po i kontrollojnë mënjëherë po e shkruajnë që ka covid. Me atë raport po shkojnë drejt për spital, diagnoza veq po është e gatshme. Si mundet me e përcaktu a ka apo nuk ka virus pa e bërë asnjë analizë. Edhe tek qështja e urës, sipas mendimit tim më mirë do te kishte qenë që hekuri te ndahet në dy pjesë dhe ura të jetë më e gjerë. Në lagjen tonë janë tri shtylla elektrike thuajse janë rrëzuar.Faleminderit.

Sevgi Mazrek:

Ju përshendes të gjithëve, sa i përket virusit në asnjë raport nuk shkruan që ka virus, veqse shkruhet dyshim për coronë. Pacientit së pari ia masim temperaturën dhe nëse ka temperaturë automatikisht po të jep sinjal që duhet me e dërgu diku tjetër.Para 2 dite ka ardhur një pacient me traktor, temperatura 40, pas

një ore ka ardhë me kërkë udhëzimin sepse e ka humbur, me orë të tëra është shëtitur me traktor. Qfarë masash me ndërmarrë ndaj këtij rasti edhe na nuk po dijmë. Pastaj erdhi edhe një pacient tjetër, edhe atë e kemi udhëzuar për në spital, ai nga QMF-ja ka shkuar privat tek mjeku Riza dhe ka marrë injeksion. Gabimi më i madhë është tek ju kryetar, këni deklarë vet që në Mamushë nuk ka coronë , këtu iu është përzier koka qytetarëve.

Buyar Mazrek:

Ky virusi e ka një të keqe që testin po e bënë shembull sot kurse rezultatet po dalin pas një jave. Në këto ditë vere Mamushës nuk mundemi në asnjë mënyrë me e ndalë, shko në Prishtinë i ke 150 Mamushali, në prizren 100 e më tepër sepse tani është sezona. Edhe krejt Kosova me u qu në këmbë nuk mundet me e ndalë, mundesh po të kishe pasur buxhet me ia dhënë qdo bujku 50,000€. Edhe qka do që flitet rreth visurit është gënjeshtë.

Sevgi Mazrek:

Një minut, ju a po besoni apo nuk po besoni që ekziston virusi?

Buyar Mazrek:

Ju jeni zyrtarë e shëndetësisë dhe e dini fort mirë që këtë virus ne e kemi pasur edhe para 3 muajve, kanë qenë të sëmurë më shumë se 300 persona. Ne duhet të mësohemi të jetojmë ke këtë grip, jeta po vazhdon.

Sevgi Mazrek

Unë jam e interesime me dit neve në QMF na kanë testuar dhe disa kanë rezultuar pozitivë, por a janë testuar edhe familjarët e tyre edhe sa familje janë testuar? Tani këto testimet që janë bërë për herë të dytë tek punëtorët e QMF-së të gjitha kanë rezultuar negativ vetëm një pozitiv, pozitiv prap karantinim kurse të tjerët nuk kanë karantinë, njëri pozitiv edhe tërë familja pozitiv, dje kanë thirrur dhe i kanë thënë pas tri dite fillojani punës, as familja nuk ka nevojë me u rritet. Pres përgjigje për këtë.

Ilyas bayraktar

I nderuar kryesues, unë nuk po kuptoj juve qfarë detyre jeni duke ushtruar, nëse anëtraja e ka marrë fjalën lëreni le të shprehet, ju qka po qëndroni aty, njëherë po thoni ka virus prap po i ndërroni fjalët jo nuk ka. Apo besoni a po nuk po besoni që ka virus? Kur anëtraja e merr fjalën duhet me respektu. Ajo deshi me tregu diqka tjetër kurse ju e perceptuat krejt një gjë tjetër. Mundet me rezultu pozitiv, por si ka mundësi që pa bërë asnjë test Prishtina po i lejon me u kthi në vende puno ose me i liru nga karantina.

Buyar Mazrek:

Këtë nuk mundet me dit askush, as kryetari i komunës bile, unë po tham që inshallah askush nuk sprovohemi me këtë sepse as Ministri i shëndetësisë bile nuk mundet me e ditë.

Ilyas bayraktar

Ju po thoni që nuk ka virus

Buyar Mazrek:

Une Buyar Mazrek them që nuk ka virus.

Halim Sadiku

Unë jam pozitiv me corona virus, e kum kalu, a e keni marrë vesh jo, a u bo kjameti a?

Ilyas Bayra

Ju nuk po e di a po e vëreni por pleqtë po vdesin nga kjo sëmundje.

Buyar Mazrek:

Edhe të rinjtë po vdesin, ti a e din që vitin e kaluar kanë vdekur 40 persona kurse këtë vit 11 dhe jemi në muajin 8të.

Ilyas Bayraktar

Të rinjtë nëse nuk kanë ndonjë sëmundje kronike munden shumë lehtë me tejkalu, por ti nëse ke ndonjë sëmundje kronike atëherë ti vdesish. Për këtë arsye duhet të ndërmirren masa që ti ruajmë të sëmuarit, të moshuarit, mos të bëhemi ne shkaktar për vdekjen e tyre. Nëse ka temperaturë, ethe, vështirësi në frymëmëarrje atëherë këto janë simptoma të virusit. Le të rrin personi në shtëpi, mos të dal me rreziku edhe jetën e tjetrit.

Halim Sadiku

Unë jam pozitiv me corona virus, e kum kalu, a e keni marrë vesh jo, a u bo kjameti a?

Abdülhadi Krasniç: Kryetar I Komunës.

Sa I përket koronavirusit unë dashta me I dhënë disa sqarime. Pasi që kemi marrë pyetje më herët po I përgjigjem me rend. Ura ka me qenë një drejtimëshë. Kthehemi tek korona virusi, virusi ekziston dhe njerëzit po vdesin, kjo nuk është një situatë normale ama siq e tha edhe Sevgia më herët askush në QMF nuk shkruan që ka virus, pa u testu. Testet mirren dërgohen në Prishtinë dhe në bazë të rezultateve vërtetohen a janë pozitiv apo negativë, ndërsa sa janë të sakta këto rezultate unë nuk mundem me ditë. Mua si kryetar komune vetëm mi dërgojnë të dhënat që në këtë ditë, me këtë datë janë marrë testet për x persona dhe x persona kanë rezultuar pozitivë, negativet nukna dërgojnë. Kohëve të fundit rastet pozitiv me virus kanë dalë vetëm tek pacientët që janë shumë të smëure që patjetër janë detyruar me shku tek mjeku. Të shumica është problem që janë munduar të marrin terapi në shtëpi, 3 -5 ditë. Mjekët në QMF-së nuk e përcaktojnë diagnozën përfundimtare por sipas simptomeve që I posedon pacienti dyshohet për virus edhe drejtoheni për ne infektiv në Prizren. Ana pozitive është që njerëzit kanë filluar me kërkim qare për veten, kanë filluar me shku në spitale. QMF-ja e Mamushës I udhëzon si të dyshimtë për spital, pacienti nuk po shkon në spital por po shkon privat, mjeku privat nuk po ja jep për me shku me bo test por pi ja shkrun një terapi dhe me atë terapi prap po vjen në QMF, vendosma infuzionin, jepma një injeksion. Dyshimi jonë që nga këta pacientë po infektohen edhe stafi I QMF-së dhe shumica e të infektuarve në QMF nuk kanë simptoma, as temperaturë, as ethe. Por duhet të mbrohem. Së fundmi pasi që ekspertët e OBSH-së po pranojnë që ka një pandemi të tillë atëherë edhe ne duhet ta pranojmë. Mua, të rinjëve ndoshta nuk na bënë asgjë por nëse në shtëpi kemi dikë të sëmurë ose të moshuar ata I mundon. Shikuar nga aspekti ekonomik ne 4 muaj kemi thënë që nuk ka koronavirus në Mamushë, kemi thënë jo sepse te askush nuk ka pasur simptoma dhe nuk kanë shkruar me bë teste edhe testet kanë filluar të bëhen kur patjetër jemi detyruar të shtrihemi në spital. Disa kanë tregu me kënd kanë pasur kontakte ndërsa disa nuk kanë deklaruar për askënd dhe këtu as komuna, as kryetari po as ministri I shëndetësisë nuk kanë kompetenca për me I dërgu me forcë me I testu. Ilyazi tha që të sjellim teste ose pajisje mjekësore nga Turqia jo sepse ti dhe unë dhe ne jemi banorë të republikës së Kosovës dhe duhet ti përshtatemi kushteve të Kosovës. Kemikërkuar ndihma, na kanë ofruar pako ushqimore, pako higjienike. Nuk munden me na dërgu staf mjekësor ose teste.

Necmedin Morina:

A ban me ndërhy pak, Novi PAzari I Sërbisë është në gjëndje shumë të rëndë dhe përmes shoqatave ka hy në kontakt me Turqinë dhe iu janë ofruar shumë ndihma qoftë pako ushqimore, higjienike, maska, dezinfektues.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar I Komunës.


Edhe neve afër 8 shoqata na kanë ofruar ndihma. Ne po dojmë që Turqia le tam merr një aeroplan, le ta mbush me pako qoftë ushqimore, higjienike, le ta mbush me barna dhe me staf mjekësor dhe le të zbrat drejt në Mamushë, most a kqyr as kush është Kosova, kush janë Ministria e shëndetësisë. Nuk ka një gjë

të tillë, ne jemi shtetatas të kosovës, po jetojmë në Kosovë dhe duhet ti përmbahemi kushteve dhe rregullave të saj.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Të nderuar anëtarë nëse nuk keni diqka me shtu në të ndryshmet atëherë mledhja ka përfunduar.
Faleminderit për pjesmarrje.

Proces mbajtësi
Idriz Mazrek



Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek

